



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 107/2013
Prishtinë, më 28.5.2013, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Fikrim Damka, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Visar Ymeri dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës i ftuar: znj. Mimoza Kusari-Lila, zëvendëskryeministre dhe ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bajraktari, drejtor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Besnik Ramadani – KDI, Darsei Canhasi dhe Dita Dobraja – INDEP, Ukë Gashi - ZPRK dhe Qëndresa Mrasori, praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina .

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.5.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-195, për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë, në baze të përfundimit të Kuvendit, Nr. 04-V-609, më datën 16 maj 2013;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 21.5.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 21.5.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-195, për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë, në bazë të Përfundimit të Kuvendit, Nr. 04-V-609, datë 16 maj 2013

Kryetari, theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës, kemi ftuar ministren e Tregtisë dhe Industrisë Mimoza Kusari - Lila, për të dhënë sqarime shtesë, lidhur me Projektligjin për tregun e naftës dhe produkteve të naftës në Kosovë dhe lidhur me shkresën për disa ndryshime në projektligj, të dërguar nga ministrja.

Shaip Muja, sugjeroi që njëherë të sqarohen procedurat se si ka ardhur shkresa e ministres dhe tha që për këtë projektligj te ne, kanë lobu “naftëtarët e vegjël”, të cilët ishin takuar edhe me ministren, dhe më pas, ministrja e ka dërguar shkresën në Kuvend, për të propozuar disa ndryshime.

Mimoza Kusari-Lila, zëvendëskryeministre dhe ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, tha se direktivat e BE-së, kërkojnë që të ketë rezerva të naftës për 90 ditë, e që sipas konsumit në vendin tonë, i bie, që duhet të ketë 150 mijë tonë rezerva, apo 180 mijë metra kub. Kosova ka 100 mijë metra kub kapacitete deponuese dhe rrjedhimisht duhet t'i shtojë kapacitetet deponuese, për të përmbushur kontratën me Komunitetin Evropian të Energjisë. Me këtë Projektligj, shtoi Kusari-Lila, do të rregullohet edhe veprimtaria me biokarburante, do të ketë thjeshtim të licencimeve, do të ketë shënjim më të qartë të autoboteve, do të ketë rregullim të çështjes së gjobave, etj. Ajo theksoi se ekzistojnë 16 deponi të licencuara, 12 prej të cilave, janë operatorë ekonomikë dhe 4 operatorë industrialë. Ajo konfirmoi se ka pas takim dy herë me “naftëtarët e vegjël”, dhe shqetësimi i tyre është se me këtë projektligj po favorizohen “naftëtarët e mëdhenj”. Gjatë debatit me “naftëtarët e vegjël”, doli ideja që krijimi i deponive të shtyhet për 3 apo 4 vite. Kërkesë e “naftëtarëve të vegjël” është që naftëtarët me pakicë, të mos jenë të obliguar të kenë deponi dhe nga biseda me ta, kemi kuptuar se “naftëtarët e vegjël” janë të pakënaqur me përfaqësuesin e naftëtarëve, sepse konsiderojnë se nuk i ka përfaqësua drejt interesat e tyre theksoi në fund ministrja.

Visar Bajraktari, drejtor për tregun e naftës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, sqaroi se në këtë projektligj kemi punuar tash dy vjet, me mbështetje të TAEX-it, dhe në bazë të obligimit ndaj marrëveshjes me Komunitetin Evropian të Energjisë, Kosova dhe çdo vend tjetër obligohen që deri më 1 janar 2023, duhet të përmbushin detyrimet që të kenë rezerva për 90 ditë.

Shaip Muja, tha që përkrah rezervat brenda shtetit dhe konsideroj se është më mirë ti kemi rezervat brenda shtetit, dhe t'u vuhet kusht naftëtarëve për sasinë e paprekshme të naftës. Muja, tha se u fol shumë për monopol dhe konsideroj që nuk ka monopol. Nëse edhe “naftëtarëve të vegjël” u lejohen deponi të vogla, atëherë pse të licencohet furnizuesi me shumicë, dhe në këtë mënyrë mund të bie edhe kontrolli i cilësisë. Ai shtoi se Shqipëria e ka ligjin për biokarburante, ndërsa në këtë Projektligj këtu, keni shumë pak për biokarburante, po ashtu edhe për riciklimin e

mbeturinave, theksoi se po ka investitorë që po vijnë, dhe ky projektligj duhet t'i ketë ato norma që e rregullojnë këtë fushë.

Teuta Sahatqija, tha se Grupi i LDK-së ka thënë që Projektligji është në kundërshtim me nenin 10, të Kushtetutës, ku garantohet tregu i lirë dhe dhënia e shansit së njëjtë për të gjithë, ndërsa, me këto kushte, disa bizneseve iu lejohet importi, e disave jo. Rezervat për 90 ditë, mendojmë që nuk duhet të kushtëzohen. Ajo theksoi se importuesi i vogël, kurrë nuk mund të rrezikoj importuesin e madh, kurse ai i madhi, të voglin po. Deponimi prej 20 % jashtë vendit, si do të zgjidhen operatorët pasi ata nuk janë të licencuar në Kosovë. Lidhur me emergjencën, deputetja Sahatqija, tha se nëse ka situatë emergjente, do të ketë në tërë rajonin, atëherë si do të kushtëzohet vendi tjetër apo operatori jashtë vendit?

Myzejene Selmani, tha se ministrja nuk ka nevojë me e dërgua Projektligjin në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa shkresa e ministres është dashtë të na jepet edhe neve me kohë. Çka është më rëndësi, duhet të angazhohemi më shumë në cilësinë e naftës, shtoi deputetja Selmani. Lidhur me rezervat e obligueshme, ajo duke iu drejtuar pjesëmarrësve nga Ministria, tha se a ia keni bërë me dije BE-së se Kosova ka vështirësi në zbatimin e ligjit për rezervat shtetërore. Sa i përket tregut të naftës, ajo tha se shteti duhet t'iu jep hapësirë të barabartë të gjithë operatorëve.

Ramiz Kelmendi, tha se në ekonominë e tregut, nafta është tregu më i lehtë, pasi që ka shumë pak artikuj. Ai tha se nuk duhet të obligohen importuesit, që njëherë ta depozitojnë naftën e mandej ta shpërndajnë. Sa i përket depozitave të naftës jashtë vendit, Kelmendi tha se nëse ka fatkeqësi, ka në gjithë rajonin, atëherë shteti tjetër nuk do ta lejon operatorin ta shes naftën në Kosovë. Ai tha se duhet t'u jepet kohë "naftëtarëve të vegjël" që ata të zhvillohen dhe një ditë edhe ata do të bëhen të mëdhenj.

Hashim Deshishku, tha se rezervat e shtetit nuk duhet të jenë jashtë Kosovës. Ai shtoi se "tregtarët e vegjël të naftës", momentalisht kanë të drejtë të importojnë dhe duhet t'i lejojmë të pajisen me licencë për import, edhe ata që s'kanë deponi.

Lutfi Zharku, theksoi se numri i licencave ndërrohet me Udhëzim Administrativ e jo me ligj, dhe ju këtë mundësi e keni pas dhe e keni edhe tani. Ai pyeti se cili është përfitimi ekonomik dhe publik nga kufizimi i importit me sigurimin e deponive. Po ashtu, duke iu drejtuar pjesëmarrësve nga Ministria, tha se ju mundeni me Udhëzim Administrativ të vendosni kushte për deponi dhe pompa tjera, pa ndryshim të ligjit. Sa i përket monopolit, mendoj, që kufizimi i konkurrencës së lirë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye e kemi kundërshtuar si LDK dhe si Grup Parlamentar.

Sala Berisha – Shala, tha që shumë çështje tashmë u diskutuan dhe gjatë shqyrtimit të Projektligjit, të angazhohemi në plotësimin e tij rreth çështjeve që u diskutuan dhe bëri thirrje që të mos humbet kohë tani në këtë fazë, por pasi që të kalon në parim ky projektligj, të punojmë si Komision.

Ministrja, Mimoza Kusari-Lila, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të deputetëve, tha se me këtë ligj, ne përcaktojmë kushtet e jo numrin e licencave, pra vendosim kushtet e jo kufizimin e tregut. Të gjithë ata që i plotësojnë kushtet, do të licencohen. Sa i përket rezervave shtetërore, ajo tha se deri 20% duhet të jenë të ruajtura jashtë vendit, e për ne parashihet ruajtja në Shqipëri. Lidhur me shqetësimet e deputetëve për kthimin e rezervave nga jashtë, ajo tha se shtetet bëjnë marrëveshje kontraktuale dhe nuk rrezikohen rezervat jashtë vendit. Çështja e deponive, po vjen si çështje që ne duhet ta plotësojmë si shtet.

Visar Bajraktari, drejtor për tregun e naftës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, tha se rezervat e obligueshme për 90 ditë, duhet ti kemi në vitin 2023, sipas marrëveshjeve me Komunitetin e Energjisë. Ai tha se deri më 2020, duhet të arrijmë 10 % shfrytëzim të biokarburanteve në transport, dhe do të fillojmë me 1% , ë vitin 2014 dhe do të vazhdojmë ta rrisim këtë përqindje në vitet në vijim, kurse siguria e rezervave jashtë vendit, tha ky, bëhet me marrëveshje bilaterale, duke shtuar se nëse nuk i përmbushim këto kushte, në si shtet mund të ndëshkohemi nga organizmat përkatës evropianë.

Kryetari, në fund tha se ne si Komision, e kemi shqyrtuar dhe miratuar këtë Projektligj në parim dhe tanimë, nuk kemi nevojë të vendosim edhe një herë për të njëjtën çështje, por kërkoj që vetëm të procedohet tutje për seance plenare, sipas procedurave.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi në parim Projektligji për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë, për konsulta shtese.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit